

VENDIM
Nr.41, datë 11.1.2012

PËR KRITERET BAZË, SEKTORËT QË DO TË MBËSHTETEN DHE MASËN E PËRFITIMIT
NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të nenit 15 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Fondet e miratuara, në buxhetin e vitit 2012, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, zëri “Transferte në buxhetet familjare”, të përdoren për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.

II. Fondet e transfertës së pakushtëzuar që do të përdoren për pemëtari, sipas nenit nr.15 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, do t’i bashkëngjiten këtij fondi dhe do të ndjekin të gjitha procedurat e vlerësimit të përcaktuara për këtë qëllim në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

III. Sektorët që do të mbështeten nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të jenë:

1. Prodhimi i frutave, arroveve e shëgëve, ullinjve dhe rrushit;
2. Prodhimi i perimeve në serra;
3. Prodhimi i qumështit, vajit të ullirit dhe mjaltit;
4. Prodhimi i produkteve organike;
5. Nxitja e kreditimit bankar në sektorin e bujqësisë;
6. Mbarështimi i njëthundrakëve;
7. Mbarështimi i kërmillit;
8. Prodhimi i bimëve medicinale.

IV. Masat e mbështetjes dhe masa e përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, në shkallë vendi, të jenë për:

1. Mbjellje ullishtesh, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për format intensive të kultivimit dhe 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale.

2. Mbjellje arrash, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha për mbjelljet me fidanë të shartuar për qarqet Kukës, Dibër, Korçë dhe rrethin Librazhd, si dhe 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha për mbjelljet me fidanë të pashartuar në të gjithë vendin.

3. Mbjellje ekstensive lajthish, bajamesh dhe shëgësh, 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë/ha.

4. Mbjellje intensive lajthish, bajamesh dhe shëgësh, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

5. Mbjellje mollësh, dardhësh, kumbullash, qershish, pjeshkësh dhe ftonjsh, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

6. Agrume, kivi dhe luleshtrydhe, 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha për format intensive të kultivimit.

7. Mbjelljen e vreshtave, në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale e mbjellë me bimët e përshkruara sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të këtij kreu, duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) dynymë.

8. Ujitjen me pika në aroret, lajthitë, bajamet e shëgët, për të gjitha format intensive të kultivimit të tyre, pemëtoret, agrumishtet, ullishtet, për të gjitha format intensive të kultivimit të tyre, dhe mbjelljet e reja, si dhe në vreshtat e reja, për rrush tavoline, serrat me ngrohje diellore dhe teknike, 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja minimale të jetë jo më pak se 2 (dy) dynymë.

9. Prodhimin e vajit të ullirit ekstra i virgjër, 100 (njëqind) lekë/litër për sasi të deri në 15 tonë/vit.

10. Prodhimin e produkteve organike bujqësore nga bimët e kultivuara në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/fermë.

11. Blerjen/zëvendësimin e plastmasit për serrat me ngrohje diellore dhe teknike, në shkallë vendi në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

12. Blerjen e plastmasit për prodhimin e bostanoreve në tunele në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për fermerët që mbjellin jo më pak se 5 dynymë shalqi.

13. Pagesën me 10 (dhjetë) lekë/litër qumësht, për numër lopësh jo më pak se 10 (dhjetë) krerë, por jo më shumë se 80 (tetëdhjetë) krerë. Pagesa të bëhet kundrejt sasive të qumështit, të deklaruara në organet tatimore.

14. Pagesën me 5000 (pesë mijë) lekë/krerë, për feramat blegtorale që mbarështojnë jo më pak se 10 (dhjetë) krerë njëhundrakë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) krerë;

15. Pagesën me 500 (pesëqind) lekë/krerë dele ose dhi të matrikuara për fermerët, të cilët mbarështojnë jo më pak se 100 (njëqind) krerë.

16. Pagesën me 600 (gjashtëqind) lekë/koshere blete, për fermerët me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) koshere blete.

17. Pagesën me 20 000 (njëzet mijë) lekë për kokë mëshqerre racëpastër të moshës mbi 15 muaj, në zona të caktuara ku ekziston përqendrimi më i madh i gjedhit, për feramat ose grup fermash blegtorale që prodhojnë jo më pak se 3 mëshqerra.

18. Mbështetjen, përmes subvencionit, në masën 70% të normës së interesit, për 5 vite radhazi për kreditë deri në 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, që do të merren për aktivitetet e mëposhtme:

a) Ruajtja dhe përpunimi i produkteve bujqësore, blegtorale, kërpudhës dhe bimëve medicinale.

b) Mjetet mekanike bujqësore, agregate dhe tank ftohës për qumështin.

c) Peshkimin dhe përpunimin e produkteve ujore.

19. Grumbullimin e gështenjës dhe shegës, 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/kv. Pagesa të bëhet vetëm kundrejt sasive të gështenjave dhe të shegëve të shitura me faturë tatimore.

20. Mbarështimin intensiv të kërmillit, 50% e vlerës së rasatit për ha, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë/ha.

Kjo mbështetje të jetë për ata që fillojnë investimin për mbarështimin e kërmillit për herë të parë.

Për mbarështuesit që e kanë bërë investimin fillestar më parë, të vihet mbështetje e fermave që bëjnë mbarështimin intensiv të kërmillit me një vlerë 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

21. Mbjelljen e bimëve medicinale të kultivuara, si, sherebelë, lavanda, timus e rigon, në bllok e sipas zonave të përcaktuara më parë për kultivim, në masën 50% të kostos totale të projektit, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha.

V. Projektet e shpallura fituese gjatë vitit 2011, për mbjelljen e arreve, shegëve, ullinjve, vreshtave, pemëve frutore e agrumeve dhe që plotësojnë kushtet për pagesë të financohen nga fondet e planifikuara të vitit 2012, sipas pagesave të përcaktuara në këtë vendim të Këshillit të Ministrave.

VI. Në komisionin e vlerësimit të projekteve për skemat mbështetëse të pemëtarisë do të marrë pjesë një përfaqësues i pushtetit vendor.

VII. 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë do të përdoren për bashkëfinancimin me projektin e IPA-s, 2011 "Bujqësia dhe zhvillimi rural".

VIII. Për informimin mediatik të publikut lidhur me masat e mbështetjes së programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2012, të përdoren nga ky fond 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

IX. Kriteret, procedura dhe mënyra e administrimit të fondit të programit përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

X. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha